



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA-SHTIME/OPSTINA-STIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME

02 Nr. 229

Dt.04.05.2018

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr.03/L-040 neni 13, dhe Statutit të Komunës së Shtimes, neni 53, Ligjit nr 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin nr 03/L-205, neni 83 dhe 123 të Ligjit nr. 05/L- 031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Vendimit të Kuvendit Komunal – Shtime Npi 01/68 datë 29.03.2018, Kryetari i Komunës mori këtë:

V E N D I M - P R E L I M I N A R

1. Aprovohet kërkesa e Drejtorisë për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi e Komunës së Shtimes, për shpronësimin e patundshmërisë për interes publik dhe atë pjesë së ngastrës kadastrale me nr. P-72809066-00774-2, në sipërfaqe prej 44 m², Zona Kadastrale – Petrovë, të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilët preken nga zgjerimi dhe asfaltimi i rrugës “Xhemshir Xhemshiri” në fshatin Petrovë sipas tabelës të bashkangjitur të këtij vendimi.

2. Obligohet Drejtoria për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi – Sektori për çështje pronësore-juridike që brenda afatit prej 5 (pesë) ditëve të punës, pas nënshkrimit të këtij vendimi – preliminar, të njoftoj pronarët e pronës së patundshme dhe zotëruesit e interesit e cila do të shpronësohet dhe brenda afatit prej 10 (dhjetë) ditëve të punës pas aprovimit të njëjtin ta shpallë në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, si dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.

3. Kundër këtij vendimi apo cilësdosje pjesë të tij kanë të drejtë të paraqesin ankesë brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike në gjykatën kompetente, subjekti kërkues dhe cilido person i cili është pronarë, apo zotërues i interesit në pronën e paluajtshme të prekur nga ky vendim.

4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen Drejtoria për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi – Sektori për çështje pronësore-juridike dhe Zyra Kryesore Financiare (ZKF).

5. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.

Iu dërgohet:

- Palës
- Zyrës Kryesore Financiare
- Drejtorisë për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi
- Arhives.

Kryetari i Komunës:
Naim Ismajli



Tabela mbi shpronësimin në bazë të vendimit Preliminarë nr 02 nr 229, datë 04.05.2018

Komuna Shtime – Zona Kadastrale –Rancë							
Nr	Pronarë	Nr.i ngastrës	Kultura -klasa	Sipërfaqja e përgjithshme m²	Sipërfaqja për shpronësim m²	Sipërfaqja e mbetur m²	Vërejtje
1	Shpejtim (Shefki) Rexhaj, nga Petrova, Komuna Shtime	P-72809066-00774-2	Arë-2	491	44	447	